

STATUTI

I SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR SH.P.K. "TEA-CO"

Mbeshtetur ne kerkesat e Ligjit 7638 dt. 19.11.1992 " Per shoqerit tregetare " krijohet dhe do te funksionoje me qender ne qytetin e Fierit Lagja "Sheq i Vogel" shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k.

Ne baze te ligjit ne fjale kjo shoqeri private e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar ka te percaktuar objektin e veprimtarise se saj, kapitalin themelor mbi te cilin eshte mbeshtetur themeli i saj, selin e shoqerise, drejtimin administrativ te saj, maredheniet kontraktuese, ate te punesimit etj.

NENI 1

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. themelohet nga ortaket zj. Antigoni Çobo dhe z. Artur Çobo me banim ne qytetin e Fierit.

NENI 2

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise se ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. do te jete per nje periudhe me teper se 10-vjete.

NENI 3

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. do te jete me qender ne qytetin e Fierit dhe aktiviteti i saj do te shtrihet ne gjithe territorin e Shqiperise dhe jashte vendit.

NENI 4

Objekti i veprimtarise shoqerise se ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. eshte i percaktuar ne keto drejtime kryesore:

Prodhime te materialeve inerte ndertimi, parafabrikateve etj.

Veprimtari investuese ndertimore per objekte civile, industriale, bujqesore, banesa dhe te tjera per persona juridik dhe fizik vendas e te huaj, agjensi transporti, tregeti, veprimtari komisionere etj.

Ndertime te objekteve social kulturore fetare etj.



Ndertime te urave dhe te tyleneve, punime karpentierive.
Ndertim linjash per shfrytezim te ujit te pijshem si dhe ndertime te kanaleve dhe kanalizimeve te cfardo lloj natyre, instalimeve te makinerive ngritese dhe transportuese.

NENI 5

Kapitali themelor mbi te cilin bazohet krijimi i shoqerise eshte 1000000 leke dhe perbehet nga mjetet kryesore te transportit dhe nga fondi i garantuar i derdhur ne Banken e Shtetit Shqiptar.

NENI 6

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. eshte person juridik privat. Kjo e fiton zotesin per te vepruar nga data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregetar ne Gjykatën e Rrethit Tirane. Rregjistrimi ne kete Gjykate eshte bere me vendimin Nr. _____ dt. _____ 1996.

NENI 7

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. detyrohet te mos ndryshoje destinacionin e vete. Ndryshimet e mundeshme do te behen ne perputhje me kerkesat e ligjit perkates si dhe me aktet qe do te dalin kete qellim.

NENI 8

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. do te zhvilloje aktivitetin e saj privat sipas bilancit me llogari me vete.

NENI 9

Veprimtarin private shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. e ushtron e mbeshtetur ne mjetet e saj financiare duke patur edhe te drejten te kerkoje kredi nga ana e Bankes se Shtetit konform dispozitave ligjore dhe nenligjore te miratuara per kete problem.

NENI 10

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. percakton vete lidhjet qe do te kete me te tretet duke i percaktuar vete nbe baze te kontrates me ata, per cmimet, afatin dhe cilesin e sherbimeve.



NENI 11

Ne caktimin e punonjesve qe do te punesohen ne shoqerine e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. vete shoqeria eshte e pavarur ne proporcion me te ardhurat qe do te realizoje.

NENI 12

Kalimi ne pronesi i objekteve qe shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. ka ne pronesi apo dhenia me qera e tyre rregullohet me dispozita te vecanta ligjore.

NENI 13

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. ushtron aktivitetin e saj ndertues sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise duke pasur parasysh e duke respektuar te gjitha dispozitat qe kane te bejne me cilesine e sherbimeve, afatin e tyre, kushtet e punes se punonjesve, rregullat e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune, rregullat e mbrojtjes nga zjarri, te mbrojtjes se mjedisit nga ndotjet etj.

NENI 14

Shtimin apo pakesimin e kapitalit themelor shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. do ta beje e nisur nga interesat e saj ne perputhje me shtimin apo pakesimin e veprimtarise qe do te kryeje.

NENI 15

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. mund te transferoje pjese te kapitalit te saj themelor ne menyre te parashikuar nga persona te tjere juridik apo fizike vendas apo te huaj. Menyra e kalimit te kapitalit themelor do te behet me kontrat te vecante qe do te lidhet midis paleve ose ne cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

NENI 16

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. ka te drejte te lere peng apo ne hipoteke nje pjese te kapitalit te saj themelor.

NENI 17

Drejtimi administrativ i shoqerise se ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. do te behet nga administratori ligjor z. Artur Çobo.

NENI 18

Organi me karakter vendimtar i shoqerise se ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. eshte asambleja e ortakeve.

Asambleja e ortakeve ka keto kopetenca kryesore :

Miraton bilancin vjetor te aktivitetit te shoqerise.

Vendos per shtimin apo pakesimin e kapitalit.

Vendos per shtimin e veprimtarise se firmes.

Cakton cmimet e shitjes se prodhimeve apo aktiviteteve te tjera qe kryen shoqeria.

Emeron administratorin ne te cilin me aktin e emerimit i caktohen detyrat dhe paga per ato qe nuk jane te percaktuara ne statut.

NENI 19

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themelor qe zoteron.

Cdo ortak mund te perfaqesohet me anen e ortakut tjeter kundrejt respektimit te institutit te perfaqesimit.

NENI 20

Ne mbledhjen e asamblese apo ne konsultimet me shkrim vendimet merren nga nje ose disa ortak qe perfaqesohen me me shume se 50% te kapitalit. Ne rast se kjo shume nuk sigurohet kjo shumice ortakesh vendos me shumice votash pavaresisht nga pjesa e kapitalit qe perfaqesojne.

NENI 21

Administratori ligjor i shoqerise se ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. ka keto kopetenca :

Te veproje ne emer te shoqerise me te tretet.

Mban pergjegjesi per mbarevajtjen e punes ne te gjitha drejtimet ku zhvillon aktivitetin shoqeria.

Lidh dhe zbaton me korrektesi kontratat individuale dhe kolektive te punes.

Perfaqeson shoqerine ne organet e administrates ato gjyqesore te arbitrazhit etj.

Merr masa per largimin nga puna te punonjesje qe shkelin disiplinën ne pune si dhe nxierr urdher cdemtimi per pergjegjesi materiale.

Harton raportin e administrimit inventarin dhe llogarit vjetore dhe ia paraqet per miratim ortakeve te tjere brenda 6-muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 22

Per te ndjekur zbatimin e veprimtarise, atp te kryerjes se sherbimeve te zbatimit te legjislacionit dhe per efekt te perfaqesimit te shoqerise tregetare perpara organeve shteterore, administrative, mund te kerkoje asistence sipas rastit.

NENI 23

Administratori i shoqerise se ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. ndjek vete maredheniet me banken.

Mjetet monetare ruhen ne llogarin e tij te sh.p.k. per kryerjen e sherbimeve te ndryshme si blerjen e mjeteve kryesore, pjeseve te nderrimit apo materialeve te tjera per likuidimin e shpenzimeve, per pagat e punonjesve etj.

NENI 24

Mjetet financiare mund te levizin edhe nga vete banka kur :

Vihet ne ekzekutim nje vendim i organit te prokurorise ose vendim gjyqsor.

Vihet ne ekzekutim nje vendim i organit te kontrollit te administrates per shkeljet administrative.

NENI 25

Per kryerjen e veprimeve financiare prane bankes shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. detyrohet te paraqese dokumente te plota dhe me afate, pa gabime dhe korrigjime si dhe te kerkoje prej bankes te mbaje te njejten korrektesi ne te tretet qe hyjne ne maredhenie me shoqerine e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k.

NENI 26

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. kerkon nga banka qe ne baze te ligjit te perfitoje nga interesat qe rrjedhin nga depozitat e ruajtura prane kesaj banke.

NENI 27

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. detyrohet te derdhe rregullisht sipas kerkesave te ligjit detyrimet per taksat dhe tatimet si dhe per sigurimet shoqerore.

NENI 28

Shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. ne maredhenie me te tretet do te lidh kontrata ne te cilat do te parashikohen te drejtat dhe detyrimet e paleve, sanksionet per mospermbushjen e detyrimit si dhe menyren e zgjidhjes se mosmarrveshjeve.

Shoqeria do te lidh kontrata ne perputhje me kerkesat e ligjit dhe do te kerkoje nga te tretet zbatimin e kushteve duke perjashtuar ato qe bien ne kundershtrim me ligjin.

NENI 29

Marrja ne pune e punonjesve te shoqerise do te behet sipas nevojave te saj duke patur parasysh kriteret profesionale dhe aftesit shendetesore.

Merrja ne pune do te behet me nenshkrimin e kontrates se punes dhe rregjistrimin ne rregjistrin perkates te shoqerise se ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k.

NENI 30

Kontrata qe lidh shoqeria me te punesuarit duhet te permaje detyrimisht keto kriteret:

Daten e lidhjes se marreveshjes se punes, kushtet e domesdoshme, profesionin e vendit te punes dhe afatin e mbarimit te marreveshjes se punes.

Po keshtu pergjegjesin materiale dhe rregullat e zgjidhjes se mosmarreveshjes se punes dhe mosmarreveshjet e tjera qe mund te lindin.

NENI 31

Ne rast te vdekjes se njerit prej ortakëve shoqeria do te vazhdoje aktivitetin me trashgimtarët e tjere ligjor.

NENI 32

Kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshme shoqeria e ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. nuk rezulton rentabel ajo pushon veprimtarin e saj.

NENI 33

Shoqeria priset ne rast falimentimi, privimin e te drejtave per te ushtruar nje profesion tregëtar ose kur vete ortakët me vullnetin e tyre vendosin per mbylljen e aktivitetit te shoqerise.

NENI 34


Me mbylljen e aktivitetit asambleja e ortakeve emeron komisionin e likujdimit i cili paraqet bilancin e likujdimit. Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te bilancit te likujdimit duke u kujdesur qe me pare te likujdohet detyrimi ndaj te treteve qe shoqeria ka ndaj tyre gjate aktivitetit te saj e me pas ndahet kapitali sipas pjeseve qe ka vendosur sejcili e bashke me te edhe fitimet e realizuara.

NENI 35

Vula e shoqerise se ndertimit me pergjegjesi te kufizuar "TEA-CO" sh.p.k. me qender ne Fier, Lagja "Sheq i Vogel" ka formen, madhesin dhe inicialet e saj.

ORTAKET E SHOQERISE SE NDERTIMIT ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "TEA-CO" SH.P.K.

ING. ARTUR ÇOBO dhe ING. ANTIGONI ÇOBO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERI MINELLA MILO
FIER
Nr. 3356 rep.

VERTETIM

Vertetohet nenshkrimi i zj. Antigoni Çobo e bija e Pavllos e datelindjes 1966 lindur ne Vlore dhe banues ne Fier dhe z. Artur Çobo i biri i Themiut I datelindjes 1963 lindur dhe banues ne Fier per identitetin e te cileve u njoha ne baze te ligjit te afte per te kryer veprime juridike te cilet me deklaruan se nenshkrimi eshte i tyre.
Une noteri e vertetoj.

Fier, me 14 / 04 / 1996

**NOTERI
MINELLA MILO**

